



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), nenit 4, pika 1.1 i Ligjit nr. 03/L-164, për financimin e programeve të veçanta të banimit (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 67/29, mars 2010) dhe të nenit 4, pika 1 e Udhëzimit administrativ nr. 23/2010, për procedurat e shpallje së programeve të veçanta të banimit, organi kompetent komunal në bazë të përcaktimit të kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjar, bën shpalljen publike të

K O N K U R S I T

Komuna ka siguruar program të veçantë të banimit për familjet që kanë mbetur pa strehim si pasojë e vendimeve të Komunës, e të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.

Të drejtën për të qenë përfitues të këtij programi e kanë familjet që:

1. kanë mbetur pa strehim si pasojë e vendimeve të Komunës,
2. janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe banorë të përhershëm të komunës së Prishtinës,
3. nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale.

Komuna për këtë program të veçantë të banimit i ka në dispozicion 5 (pesë) banesa, që do t’i ndajë për familjet që kanë mbetur pa strehim si pasojë e vendimeve të marra nga Komuna e Prishtinës.

Organi kompetent komunal bën shpërndarjen e kërkesave në formë standarde, pa pagesë, për të gjithë kërkesit e interesuar. Ato mund t’i marrin në zyrën /sportelin nr. 3, kati përdhes në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës, rruga UÇK, nr. 2, çdo ditë pune nga ora 08:30 – 15:00.

Kërkesa e plotësuar dhe dokumentacioni i nevojshëm që duhet t’i bashkëngjitet kërkesës, mund të dorëzohen çdo ditë pune në Komunën e Prishtinës.

Kërkesat e dorëzuara pas afatit kohor, të pakompletuara dhe të paplotësuara me të dhënat e nevojshme, nuk do të pranohen dhe nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursi mbetet i hapur 30 (tridhjetë) ditë nga shpallja publike në njëri nga gazetatat e përditshme, si dhe në ueb-faqen e Komunës, duke filluar prej datës **5.7.2017** deri më **3.8.2017**.

Komisioni për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve bën shqyrtimin e kërkesave brenda 30 (tridhjetë) ditëve, duke u bazuar në vendimet e marra nga Komuna, si pasojë e të cilave familjet kanë mbetur pa strehim.

Kohëzgjatja e përfitimit të kësaj kategorie në programin e veçantë për banim është 3 (tri) vjet.

Komuna do ta publikojë listën e familjeve që do jenë përfitues të këtij programi në tabelën e shpalljeve.

Kur aplikuesi me vetëdije jep deklaratë të rrejshme, apo paraqet dokumentacion të falsifikuar, humb të drejtën për t'u kualifikuar si shfrytëzues i këtij programi të veçantë të banimit.

Pas shpalljes së listës së familjeve përfituese nga ky programi banimi, familjet e pakënaqura mund të parashtrijë ankesë me shkrim në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kundër Vendimit të Komisionit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve prej ditës së pranimit të Vendimit.

Shtojca 2. Dokumentacioni i nevojshëm:

1.	Fotokopja e letërnjoftimit për parashtruesin e kërkesës;
2.	Certifikatat e lindjes për anëtarët e familjes të parashtruesit të kërkesës;
3.	Certifikatat familjare;
4.	Vërtetimi (informatë) mbi vendbanimin e përhershëm;
5.	Të dhënat për anëtarët e punësuar (nga punëdhënësi) dhe burimet e të hyrave të rregullta;
6.	Vërtetimi nga MTI që personi kërkuar dhe anëtarët e familjes nuk kryejnë aktivitet tregtar;
7.	Vërtetimi nga Enti për Punësim për të gjithë anëtarët e familjes të papunë;
8.	Vërtetimi mbi shkollimin e rregullt;
9.	Të dhënat mbi gjendjen shëndetësore të parashtruesit të kërkesës apo të anëtarëve të familjes, të lëshuar nga ana e enteve shëndetësore të autorizuara ose të komisioneve profesionale;
10.	Dokumentet shtesë të nevojshme : Vendimi komunal /Raport komunal